



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1642/4 prot.

Datë 17.09.2021

V E N D I M
Nr. 639/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.09.2021 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK me Nr. REF-97578-06-07-2021, Loti 8, me objekt “Hemofiltrues” me fond limit 3,276,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
- Autoriteti Kontraktor:** “Biometric Albania” SHPK
Rruga “Vllazën Huta”, Pall.Vila Park 1/6/25, Tiranë
- Ankimues:** Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.06.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit me Nr. REF-97578-06-07-2021, Loti 8, me objekt “Hemofiltrues” me fond limit 3,276,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 30.08.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.3. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 01.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK, ka paraqitur ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.4. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton, se në datën 01.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të

dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1642/2 prot., datë 02.09.2021, janë publikuar arsyet e skualifikimit të ankimuesit për të cilat ai ngre pretendime.

II.6. Me shkresën nr. 2277/4 prot, datë 09.09.2021 protokolluar me tonën me nr. 1642/3 prot datë 13.09.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar pjesërisht ankesën.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Në datën 08.06.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit me Nr. REF-97578-06-07-2021, Loti 8, me objekt “Hemofiltrues” me fond limit 3,276,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

III.1.2. Në datën 30.8.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.1.3. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 01.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK ka paraqitur ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.4. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se në datën 01.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1642/2 prot., datë 02.09.2021, janë publikuar arsyet e skualifikimit të ankimuesit për të cilat ai ngre pretendime.

III.1.6. Me shkresën nr. 2277/4 prot, datë 09.09.2021 protokolluar me tonën me nr. 1642/3 prot datë 13.09.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor e ka pranuar pjesërisht ankesën.

III.1.7. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.8. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.9. Neni 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.10. Neni 111, pika 1, i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.1.11. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në datën 01.09.2021, ndërkohë referuar verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit, u konstatua se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kryer njoftimi i fituesit dhe as publikimi i njoftimit të fituesit për këtë procedurë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimin/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi në datë 01.09.2021 (data që ankimuesi ka paraqitur ankesën në autoritet kontraktor dhe KPP) nga ana e autoritetit kontraktor nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, në datë 01.09.2021 afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar akoma, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, që do të thotë se ankimuesit nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në datën 01.09.2021, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

III.1.12. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me

ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Lidhur me vendimin e autoritetit kontraktor të datës 09.09.2021, me anë të së cilit ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga nenet 110 dhe 111 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetiniciatore e fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, ku një prej të cilave është dhe respektimi i afateve të ankimit. Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave në asnjë rast nuk duhet të marrë në shqyrtim një ankesë e cila është paraqitur në mungesë të kushteve formale dhe respektimit të afateve të ankimit. Për këtë arsye, Komisioni gjykon se vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për pranimin pjesërisht të ankesës të operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK, është në kundërshtim të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndaj ky vendim do të shpallet absolutisht i pavlefshëm nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK me Nr. REF-97578-06-07-2021, Loti 8, me objekt “Hemofiltrues” me fond limit 3,276,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

**Anëtar
Kreshnik Ternova**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**